



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 24

Datë: 15. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr. 22/2023

2. Rekomandimet nga ZRCKFSP

Shqyrtimi i rekomandimit për pezullimin e partisë politike Republikanet e Kosoves

3. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

- Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës për KQZ nga OSBE ODIHR në Punëtorinë Rajonale për Administrimin Zgjedhor, Sarajevë, Bosnje dhe hercegovinë;

- Ftesë nga International Republican Institute për pjesëmarrje në Open Government Partnership Annual Summit, Tallin, Estoni

4. Këshilli për Personel

- Njoftim nga Grupi punues për draftimin e Rregulloreve të Brendshme të KQZ;
- Rekomandimet nga Sekretariati i KQZ;

5. Të ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr. 22/2023

Kryetari Radoniqi e hapi mbledhjen, paraqiti agjendën dhe pyeti anëtarët nëse kanë diçka lidhur me rendin e ditës. Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës dhe miratuan procesverbalin e mbledhjes nr. 22/2023 nga mbledhja e KQZ.

2. Rekomandimet nga ZRCKFSP

Shqyrtimi i rekomandimit për pezullimin e partisë politike Republikanet e Kosovës:

Besnik Buzhala, paraqiti një rekomandim lidhur me pezullimin e një subjekti politik. Bëhet fjalë për subjektin “republikanët e rinj”, me akronimin “REK”. Ky subjekt, nuk e ka mbajtur kuvendin. Ka qenë e obliguar ta mbaj kuvendin më 03.08.2023, mirëpo nuk e ka mbajtur. Në bazë të rregullës së KQZ-së, kjo parti duhet të pezullohet me kusht që brenda 45 ditëve ta mbaj kuvendin zgjedhor!

Ne si zyre, rekomandojmë të pezullohet ky subjekt.

Me 11 vota për, pra me vota unanime pezullohet partia politike Republikanet e Kosovës.

Kreshnik Radoniqi: Dy pikat e radhës i kemi të mbyllura. Janë pika të brendshme dhe nuk kanë të bëjnë me publikun!

3. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës për KQZ nga OSBE ODIHR në Punëtorinë Rajonale për Administrimin Zgjedhor, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë:

Kreshnik Radoniqi: Në këshill, e kemi shqyrtuar këtë ftesë. Jemi dakorduar që të shkojmë me katër persona, mirëpo nuk jemi përcaktuar kush të shkojë...

Ilir Gashi, tha se nuk e di se si do të udhëtojmë për shkak që kemi mungesë vizash. Sami Kurteshi, tha se unë personalisht nuk kam ndërmend të udhëtoj por, propozoj që të shkojnë Arianit Elshani dhe Alban Kurtshi që, mendoj se punojnë...

Jam i interesuar të punojmë, jo të shkojmë si për shembull 30 vetë janë propozuar të shkojnë në Tiranë, e janë punuar vetëm 5 rregullore. Ma mirë ka qenë të punohen këtu, e unë dua të shkojnë ata që punojnë e jo të zhvatet buxheti.

Ilir Gashi, tha se këndvështrimet janë të ndryshme. Mirëpo, ka pas një përcaktim që ka mbet që KOZ ti shqyrtoj rregulloret, dhe jo të tjerët. E pas kësaj, ti shqyrtojmë dhe miratojmë...

Sa i përket udhëtimeve, unë nuk përzihem në qëndrimet subjektive por përfaqësimet, vizitat studimore etj., nuk i masim me punë por vendosim këtu kush mundet me shkue e kush jo... **Rifat Kurteshi,** tha se ne jemi 11 vetë dhe Samia nuk e përcakton se, kush sa punon...! T'i, a e voton a se voton, e ti s'mundesh me vendos...!

Sami Kurteshi: Unë fola atë që po e shoh dhe që po e vërejë. E drejta e votës është e drejtë, por unë po them se nuk votoj më delegacion me shkue 30 vetë për 10 veta sa mund të punojnë këtu! Nuk janë çështje private të mia, por për vlerësime private.

Čemailj Kurtiš, tha se duhet të diskutojmë pa tension, me fakte dhe se Kurteshi dha vlerësimin e tij, pra edhe për Arianitin dhe Albanin. Mirëpo, kjo s'do duhej me kanë vetëm punë e KOZ-it, por edhe ne e të tjerëve. Kush sa mundet, mirëpo hajde të shohim cilat janë temat, kush të shkoj dje të vendosim për këta persona. Mjetet që i shpenzojmë, duhet të kemi kujdes se si i shpenzojmë...

Sami Hamiti: Mendoj që Arianit dhe Albani kanë punuar më shumë në rregullore. Nuk kemi kuorum por bartës është KOZ-i. Kurse vizitat nuk varen tani vetëm nga një apo dy punë, janë dy vizita. Në këtë pikë, janë njerëzit që e njohin administrimin zgjedhor. Kjo pjesë ka të bëjë me reformën zgjedhore. Unë për vete nuk shkoj as në të parën dhe as në të dytën...

Ibrahim Selmanaj, tha se nuk e di si udhëtohet...! Jam që Iliri të shkoj, mirëpo s'kemi ndonjë praktikë, nuk e di si udhëtohet në Bosnje dhe Hercegovinë...

Kreshnik Radoniqi: Kemi dy propozime: Albani, Arianiti dhe Iliri. Edhe një propozim...? Unë personalisht, nuk aplikojë...

Alban Krsniqi: Nuk e di qëndrimin por, mendoj Qemali të jetë në listë.

Kreshnik Radoniqi: Dy ditë janë në pyetje, udhëtojmë në fund të shtatorit...

Arianit Elshani: T'i kemi katër propozime, e pastaj...

Kreshnik Radoniqi: Arianiti, Iliri, Rifati dhe Fazliu.

Me tetë vota për, një abstenim (Rifat Krasniqi) miratohet.

Ftesë nga International Republican Institute për pjesëmarrje në Open Government Partnership Annual Summit, Tallin, Estoni:

Kreshnik Radoniqi, tha se ftesat kanë qenë vetëm për zyrën, janë dy ftesa. Mendojmë të udhëtojmë unë dhe Vesa Xharra.

Arianit Elshani: Konsideroj që është mirë me pas më shumë pjesëmarrës. Sepse, ajo çka ofrohet atje është shumë e rëndësishme. Le të kontaktohet nëse ka mundësi të shkohet edhe ndonjë person shtesë, dhe unë propozojë të shkoj Albani.

Kreshnik Radoniqi. E kemi vendimin. Nëse kjo na mundësohet, vetëm e plotësojmë...

Mbledhja ka vazhduar me dyer të mbyllura...

4. Këshilli për Personel

Njoftim nga Grupi punues për draftimin e Rregulloreve të Brendshme të KQZ:

Rekomandimet nga Sekretariati i KQZ:

5. Të ndryshme !